



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **Operatorin ekonomik “KRIJON ” sh.p.k**

Adresa: **Tiranë,Farkë,Rruga e Elbasanit Nr, 57 Çollak,1044**

Procedura e prokurimit: **“E hapur-Mallra”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-46386-12-17-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje reagentë dhe paisje laboratorit”**

Fond limi **9,415.613** (nëntë milion e katëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e trembedhjetë) leke pa tvsh.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Buletini i Njoftimeve Publike Nr.51 date 23.12.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Gamma”sh.p.k

K31510153H

Vlera 0 (zero)

2. “ Albuji” sh.p.k

K64112206J

Vlera 7,912,200 (shtatë million e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

3. “ Moto - Mania” sh.p.k

L32203009T

Vlera 8,301.800 (tetë million e treqind e një mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.

4. “ Almedical” sh.p.k

K21511002I

Vlera **8.612.200** (tetë million e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

“Krijon ”sh.p.k

K12023001A

Vlera 9.347.920 (nëntë million e treqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Gamma”sh.p.k

K31510153H

Vlera 0 (zero)

2. “ Albuji”

K64112206J

Vlera 7,912,200 (shtatë million e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

3. “ Moto - Mania”

L32203009T

Vlera 8,301.800 (tetë million e treqind e një mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.

4. “ Almedical”

K21511002I

Vlera 8.612.200 (tetë million e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët e mëposhtëm:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “GAMMA”sh.p.k 0(zero)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**Gamma sh.p.k**” nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**Gamma ” shpk**” s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

2.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Albuji sh.pk me ofertë 7.912.200(shtatë milion e

nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari në kushtet e përgjithshme të kualifikimit AK ka kërkuar si më poshtë cituar:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të paraqitur nga operatori ekonomik “Albuji”sh.p.k vëren se nuk ka paraqitur deklaratën e kritereve të përgjithshme të kualifikimit çka bie në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në DST.

Në shtojcën 9 të DST shprehet se**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 2.7 si më poshtë cituar:

Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për objektin e prokurimit për mallrat e kërkuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e

tij.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik autorizim prodhuesi datë 12 prill 2017 lëshuar nga kompania HACH.

Referuar dokumentacionit të mësipërm KVO konstaton se autorizimi i paraqitur nga operatori ekonomik Albujë sh.p.k është në gjuhë të huaj.

Referuar nenit 14 të VKM nr,914 datë 29.12.2014”Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht: **“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”**. **Në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika IV.6 është përcaktuar shprehimisht: “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër .**

Gjithashtu në kriteret e pergjithshme të kualifikimit shtojca 9 citohet se **Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.**

Përsa më sipër K.V.O gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Albujë sh.p.k është i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Pra,përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Motomania sh.p.k me vlerë 8.301.800 lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

Së pari në kushtet e veçanta të kualifikimit pika 2.10 AK ka kërkuar si më poshtë cituar:

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi.

Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik katalogje të prodhuesve të ndryshëm.

Referuar dokumentacionit të mësipërm KVO konstaton se katalogjet nga operatori ekonomik MotoMania sh.p.k janë në gjuhë të huaj.

Referuar nenit 14 të VKM nr,914 datë 29.12.2014”Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht: **“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”.** **Në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika IV.6 është përcaktuar shprehimisht: “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër.**

Gjithashtu në kriteret e përgjithshme të kualifikimit shtojca 9 citohet se **Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.**

Mosparaqitja e katalogjeve në gjuhën shqipe e bën të pamundur identifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar, pasi katalogu nuk përmban vetëm të dhëna teknike (si përmasa etj.), por edhe përshkrim të produktit.

Përcaktimi i bërë në dokumentat e tenderit, si në seksionin IV, ashtu edhe në Shtojcën 9 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, aq më tepër në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përkufizuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër K.V.O gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Motomania sh.p.k është i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Pra,përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

K

4.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik AlMedical sh.p.k me ofertë 8,612,600 (tetë milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.7 si më poshtë cituar:

2.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për objektin e prokurimit për mallrat e kërkuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i

autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

KVO vëren se në përmbushje të kriterit të kërkuar për zërat e kërkuara nga AK nr.31, nr.59,nr.60,nr.61,nr.63,nr.64,nr.67,nr.68,nr.69,nr.70,nr.71,nr.72,nr.73,nr.74,nr.75,nr.86 ,nr.87,nr.88,nr.103,nr.107 (referuar dhe ofertës teknike të paraqitur nga operatori ekonomik Almedical sh.p.k)ka paraqitur autorizim prodhuesi lëshuar nga kompania Merck datë 27.11.2017 për kompaninë VARUS.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur KVO konstaton se distributori VARUS ka lëshuar autorizim distributori për operatorin ekonomik Almedical sh.p.k për mallrat e kërkuar në zërat e mësipërm.

Referuar autorizimit të kompanisë Merck KVO për kompaninë VARUS konstaton se dokumenti i paraqitur është i paplotë.

Konkretisht në autorizimin e kompanisë Merck datë 27.11.2017 për kompaninë VARUS mungon emri i personit që e ka lëshuar,firma si dhe vula e kompanisë Merck.

Në shtojcën 9 e DT shprehet se ...”Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumentave të rreme e të pasakta konsiderohen si kushte për skualifikim.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i mësipërm do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Gjithashtu për zërat e mallrave nr.100,nr.101,nr.102,nr.106 (referuar dhe ofertës teknike të paraqitur nga operatori ekonomik Almedical sh.p.k në sistemin elektronik)ka paraqitur autorizim prodhuesi lëshuar nga kompania Labbox Labëare për kompaninë KappaLab.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur KVO konstaton se distributori Kappa Lab ka lëshuar autorizim distributori për operatorin ekonomik Almedical sh.p.k për mallrat e kërkuar në zërat e mësipërm.

Referuar autorizimit të prodhuesit Labbox për kompaninë KappaLab, KVO vëren se prodhuesi ka autorizuar kompaninë Labbox të përdorë dhe të furnizojë mallra vetëm për territorin e Greqisë.

Duke qënë se autorizimi i lëshuar nga prodhuesi Labbox për kompaninë KappaLab është ekskluziv vetëm për territorin e Greqisë KVO gjykon se distributor Kappa Lab nuk mund të lëshojë autorizim distributori për shoqërinë Almedical sh.p.k.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i mësipërm do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së dyti AK në specifikimet teknike për procedurën objekt prokurimi ka kërkuar:

99	Kape kimike	<p>Gjerësia 1800 mm, Thellësia 750 mm, <u>Lartësia totale 2250 - 2450 mm</u>, Lartësia e punës 900 mm. Punohet me solvente të ndryshëm dhe reagentë agresivë, sipas standartit EN14175 Pajisur me sistem ventilimi (aspirator centrifugal) rezistent nga ataku kimik. Kapaciteti thithës sipas standartit EN 14175. Komplet me sistemin e aspirimit. Syprina e punës me material antiacid qeramike e emaluar sipas standartit EN-121-A1 me rezistencë ndaj goditjes dhe temperaturave të larta. Suporti me strukturë metalike të veshura me material rezistent ndaj reagentëve të ndryshëm agresivë. Rezistenca për ngarkesa mbi tavolinë 300 kg. Pajisur me lavaman të vogël (anësor), të integruar në syprinën e punës. Pajisur me rubinet uji rezistent ndaj avujve të reagentëve me komandim nga jashtë kapës. Kompletuar me ndriçim antideflagrant me panel elektrik konform standartit për laborator kimik. Pjesa ballore me xham të lëvizshëm me sistem kundrapeshe për frenim e fiksion në çdo lartësi të hapjes. Me panel komandimi elektronik, kontrolli të fluksit dhe sistem sinjalizimi. Furnizuesi duhet të kryejë edhe punimet e plota të instalimit : furnizimet me energji të prizave të kapes, ndricimit dhe të sistemit të ventilimit, tubacionet e aspirimit me rakorderite perkatese, shtrirjen e linjave të furnizimit me uje, shtrirjen e tubacioneve të shkarkimit të ujrave të ndotur deri ne pusete</p>	
----	-------------	--	--

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit në sistemin elektronik të katalogjeve teknike të përkthyer për zërin kapë kimike vëren se nuk është pasqyruar lartësia totale duke bërë të pamundur identifikimin e përshtatshmërisë së pajisjes së paraqitur nga operatori me parametrat e ambientit të kërkuara nga AK.

Gjithashtu në specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik rezulton se kapa kimike nuk është e pajisur me lavaman së bashku me instalimet hidraulike me qëllim përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara nga AK

Së dyti në specifikimet teknike për zërat nr.100,nr.101 Autoriteti Kontraktor ka kërkuar si më poshtë cituar:

<p>Tavolina laboratorit mikrobiologji 1.5m</p>	<p><u>Gjatësia e tavolinës 1500mm, Gjerësia 900 mm, lartësia 900 mm.</u> Struktura metalike me profil çeliku katror të veshur me bojë të pjekur, veshur me rezinë speciale epoksi, rezistente ndaj kimikateve, ngarkesa mbi tavolinë 300 kg. Me mundësi nivelimi nëpërmjet regjistrimit të mbështetësve të këmbëve të tavolinës. Materiali i suprinës: xham i temperuar, rezistente ndaj goditjes, shokut termik, kimikateve dhe gërvishtjes, bordura anësore polipropylene, izolacioni silikon i zi antiacid. Trashësia e syprinës 30 mm. Me bordure murale me gjerësi 150 mm ±1% dhe lartësi 200 mm ±1% nga niveli i banakut. Një bllok me dy priza shuko të montuara në faqen vertikale të bordurës murale për çdo një metër e gjysëm gjatësi. Furnizuesi duhet të kryejë edhe punimet e plota të instalimit : shtrirjen e kabllave të furnizimit me energji të prizave</p>
<p>Tavolina laboratorit mikrobiologji 1.8m</p>	<p><u>Gjatësia e tavolinës 1800mm, Gjerësia 900 mm, lartësia 900 mm.</u> Struktura metalike me profil çeliku katror të veshur me bojë të pjekur, veshur me rezinë speciale epoksi, rezistente ndaj kimikateve, ngarkesa mbi tavolinë 300 kg. Me mundësi nivelimi nëpërmjet regjistrimit të mbështetësve të këmbëve të tavolinës. Materiali i suprinës: xham i temperuar, rezistente ndaj goditjes, shokut termik, kimikateve dhe gërvishtjes, bordura anësore polipropylene, izolacioni silikon i zi antiacid. Trashësia e syprinës 30 mm. Me bordure murale me gjerësi 150 mm ±1% dhe lartësi 200 mm ±1% nga niveli i banakut. Një bllok me dy priza shuko të montuara në faqen vertikale të bordurës murale për çdo një metër e gjysëm gjatësi. Furnizuesi duhet të kryejë edhe punimet e plota të instalimit : shtrirjen e kabllave të furnizimit me energji të prizave</p>

Referuar katalogjeve teknike të paraqitura për mallrat e mësipërme vërehet se përmasat e paraqitura nga operatori nuk janë konform specifikimeve teknike të kërkuar nga AK.

Konkretisht vërehet se ka shmangie në parametrin gjerësi.

Ndërkohë që kjo përmasë është kërkuar në dimensionin 900 mm nga AK, operatori ekonomik i

ka paraqitur në përmasat 750 mm çka bie në kundërshtim me përmasat e kërkuar nga AK.

Së treti në specifikimet teknike për zërin nr.106 AK ka kërkuar si më poshtë cituar:

106	Furnelë ngrohese qeramike	<u>Fuqi ngrohese jo me pak se 1200 Ë, Diametri i zones se nxehjes 160-180mm,</u> temperature maksimale jo me pak se 570 °C, koha e vlimit per 1 liter uje 10-12min , Syprina me material prej qelqi qeramike, forme katrore me dimension brinje 28-30 cm, Me mbrojtje ndaj mbinxehjes, Me mbrojtje IP20, peshembajtje te pakten 25 kg.
------------	---------------------------	---

Operatori ekonomik Almedical sh.p.k në specifikimet teknike për zërin e mësipërm të përkthyer në gjuhën shqipe KVO vëren se mungon parametri i fuqisë ngrohëse I kërkuar nga AK jo më pak se 1200Ë.Gjithashtu KVO konstaton se nuk është pasqyruar diametri i zonës së nxehjes i furnelës ngrohëse duke bërë të pamundur identifikimin e përmasave të pajisjes së kërkuar nga AK.

Së katërti AK në specifikimet teknike për zërin nr.107 AK ka kërkuar si më poshtë cituar:

107	Turbidimeter	Matje te turbiditetit sipas ISO7027, diapazoni I matjes 0.02-1100 njesi nefelometrike. Rezolucion 0.01 per matje ne nivele te ulta. saktesia 0.01NTU. Matje automatike, kalibrim automatik me 3 pika me precizion te larte. Dokumentim sipas AQA dhe GLP. Me mundesi vendosje te numrit te identifikimit te mostres. <u>Memorje per ruajte jo me pak se 1000 matje.</u> Mundesi lidhje me PC dhe softëare per administrimin e te dhenave. komplet me 3 standarte turbiditeti
------------	--------------	---

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë verifikimit të katalogjeve teknike të përkthyer për zërin nr.107(turbidimeter)konstaton se mungon aftësia memorizuese e pajisjes që ka ofertuar operatori ekonomik Almedical sh.p.k.

Mungesa e memorizimit sjell si pasojë mosruajtjen e vlerave të matjeve në kohë reale.

Sqarojmë operatorin ekonomik se kërkesa për katalogjet e mallrave referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofertuar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Në rastin konkret mallrat e mësipërm të ofertuar nga operatori ekonomik ofertues nuk përmbushin të gjitha specifikimet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt prokurimi.

Kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Theksojmë se nëse do të kishit pretendime mbi vendosjen e specifikimeve teknike keni pasur momentin procedural për të paraqitur ankesë parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP si dhe në rast paqartësie mbi vendosjen e specifikimeve teknike ushtrimin e të drejtës për të kërkuar sqarime bazuar në nenin 42 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

KVO gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "Krijon" sh.p.k me adresë Tirane Farkë, Rruga e Elbasanit Nr, 57 Çollak, 1044 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9.347.920** (nëntë milion e treqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvsh. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ukt Sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më **datë 24.01.2020**

Ankesa: PO(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë **04.02.2020**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomikë "**Albuji**" sh.p.k hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.2736 Prot. datë 29.01.2020 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: "**Blerje reagent dhe paisje laborator**"

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për

miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 28860/4 Prot. dt. 29.01.2020 , është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 28860/5 Prot. datë 29.01.2020 , u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e OE “**Albuji**” **shpk** , ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik të mësipërm dhe është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vleresimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatori Ekonomik “**Albuji**” **shpk** me ane të shkresës Nr. K-275/1 datë 04.02.2020 (administruar në dosjen e prokurimit).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më **datë 24.01.2020**

Ankesa: PO(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë **04.02.2020**